

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/02/02

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-57157-01-26-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

Bashkia Vore

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

3333333

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Blerje Kancelari për Bashkinë Vorë

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/02/06

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/02/06

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

-57157-

30125120-830192124-630192130-130192930-

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/dis operatorit/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër □

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vore, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 27.01.2023, ora 1000, tenderin me objekt “Blerje kancelari per Bashkine Vore”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 06.02.2023, ora 1000.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

1. Ne shtojcen 6 “Formulari I sasise dhe grafiku i levimit” eshte percaktuar se afati levimit te mallit per kete procedure do te jete 10 dite:

“Afatet e lëvrimit: Brenda 10 diteve nga data e nenshkrimit te kontrates.”

Ju sjellim ne vemendje se per kete procedure, prokurohen 74 artikuj, ne sasi te medha. Afati prej 10 ditesh nuk eshte i mjaftueshem dhe nuk eshte ne perpjestim te drejte me natyren e kontrates. Per shembull, tek artikulli Nr.11 kerkohen 100cope tonera, sasi kjo e konsiderueshme, te cilen s’mund ta kemi ne gjendje, pasi konkretisht kjo paisje nuk eshte shume e perhapur dhe kerkesa per kete toner eshte shume e rralle.

Nr	Pershkrimi	Oem	Specifikimet teknike	Njesia	Sasia
11	Boje fotokopje	Kyocera Ecosys	2135dn TK-1150 1T02RV0NL0	E pahapur	, me Qr
	Code	qe tregon origjinalitetine produktit sipas kompanise prodhuese te paisjeve	cope	100	

Artikujt objekt I kesaj kontrate, nuk jane me baze prodhimi vendas, por importohen nga firmat prodhuese nderkombetare dhe kalojne nje sere procedurash, te cilat ne asnje rast, nuk permbyllen brenda ketij afati.

Kerkesa juaj per levrim brenda 10 ditesh, diskriminon te gjithë OE te interesuar te marrin pjese ne kete procedure, por qe nuk mund t’I mbajne gjendje keto tonera, por I porosisin ne momentin e shpalljes se fituesit perfundimtar. Te gjithë jemi te ndergjegjshem per problematikat dhe afatet e procedurave te transportit, te zhdoganimit etj, te cilat gjithnje zgjasin me shume se 10 dite, aq me

teper qe brenda ketij afati duhet te jete perbyllur edhe levrimi ne kete institucion. Me kete kerkese, AK favorizon dhe drejton dhenien e kontrates, vetem ne OE qe I ka gjendje mallrat objekt prokurimi, duke paracaktuar fituesin.

Ne PV e argumentimit te kriterëve dhe specifikimeve, AK nuk ka arritur te argumentoje se perse eshte I nevojshem ky afat levrimi kaq I ngushte qe krijon kufizim konkurrence dhe diskriminim te OE.

Vlen te permendim, se disa here, AK , ia kalojne te gjithë barren e emergjencave per furnizim, OE te interesuar per te fituar kontraten, nderkohe qe kane te gjithë mundesite te bejne planifikimet e tyre ne kohe, qe te mos gjenden perballe “situatave emergjente”. Ne procedurat e mepareshme, Bashkia Vore, ka proceduar me afate levrimi prej 30 ditesh, qe eshte afati me normal dhe I zakonshem per keto lloj kontratash.

Ju lutemi, mirekuptoni domosdoshmerine e OE per nje afat levrimi prej 30 ditesh dhe modifikoni kete kriter.

2. Ne kriteret e vecanta ne DST, ne piken 2.3.4, AK ka kerkuar:

“2.3.4 Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari duhet te paraqese prane Autoritetit Kontraktor mostrat per zerat e kerkuar sipas afatit te dorezimit te dokumentacionit.”

? Se pari veme re se AK ka kerkuar mostra per te gjithë artikujt objekt prokurimi, gjithesej 74 artikuj. Kjo kerkese eshte e ekzagjeruar dhe ne tejkallim te ligjit, pasi AK po kerkon mostra dhe per artikuj ne sasi shume te vogla.

Lidhur me paraqitjen e mostrave per cdo artikull, KPP eshte shprehur ne vendimin K.P.P. 122/2020: “Kërkesa për dorëzimin e mostrave për secilin artikull, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”

Lutemi te modifikohet kerkesa per mostra pasi kerkesat duhet te jene ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates, te kerkohen mostra vetem per artikujt me perdorim me te madh. Duke kerkuar mostra per te gjithë artikujt, edhe per ato qe AK do ti bleje ne nje sasi fare te vogel, ngarkohen OE me shpenzime ekonomike te panevojshme, pasi detyrohen te blejne te gjitha mostrat, qe ne momentin e ofertimit, pamvaresisht se kur kerkon AK paraqitjen e tyre. Kjo per arsyen se, edhe afati prej jo me shume se 5 ditesh nga njoftimi paraprak I fituesit, eshte I pamjaftueshem per sigurimin e te gjitha mostrave.

Se dyti, jemi te paqarte mbi dorezimin e mostrave se bashku me dokumentacionin, pra pas fazes te hapjes te ofertave.

Paraqitja e mostrave I sherben AK per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve teknike te kerkuara, ne menyre qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij. Gjithashtu ne procesverbalin e argumentimit te specifikimeve teknike AK eshte shprehur:

“Kriteri i kërkuar në lidhje me dorezim mostrash është vendosur në përputhje me pikat 1, te udhezimit nr.3 date 12.04.2022, si dhe te pikes 6/a të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar). “

Pika 1 e udhezimit nr.3 date 12.04.2022, percakton:

“Autoriteti/Enti kontraktor, mund tu kerkoje operatorëve ekonomike te dorezojne mostra te mallit,

objekt prokurimi, kur gjykon se eshte e rëndesishme për vleresimin e aspektit teknik te ofertës. Ne do rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te argumentoje teknikisht vendosjen e kriterit per kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet tepasqyrohet ne procesverbalin e argumentimit te specifikimeve teknike de kriterëve te veçanta te pranimit, i cili publikohet se bashku me dokumentet e tenderit ne Sistemin e Prokurimit Publik (ne vijim SPE).”

Sjellim ne vemendje qendrimin e KPP ne nje situate te tille, ku nepermjet Vendimit Nr.551, date 13.06.2022 eshte shprehur:

“?kërkesa për paraqitjen e mostrave, parashikohet si një ndër kërkesat e cila duhet përmbushur për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Pra ligjvënësi ka parashikuar këtë kërkesë, si një kriter i cili duhet përmbushur nga operatori ekonomik i cili synon të fitojë kontratën, si dhe ti shërbejë autoritetit kontraktor me qëllim verifikimin nëse produktet e paraqitura plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pra në fazën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Sa më sipër, kërkesa mbi momentin e dorëzimit të mostrave “jo më vonë se pesë ditë nga shpallja e njoftimit përfundimtar të fituesit”, është një kërkesë e cila nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, pasi sipas nenit 40 të VKM, kërkesa për dorëzimin e mostrave është një kriter kualifikimi në procedurë dhe jo kriter për përmbushje pas shpalljes fitues. Sa më sipër autoritetit kontraktor, të modifikojë kërkesën e mësipërme në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.”

Nga sa me lart, eshte e rëndesishme qe mostrat te paraqiten ne fazen e hapjes te ofertave, ne menyre qe te verifikohet perputhja e mostres se paraqitur me cmimin dhe me specifikimet teknike. Kerkojme modifikim te ketij kriteri.

3.Ne preventivin e specifikimeve teknike, AK ka paraqitur tabelen si me poshte:

Nr	Pershkrimi	Oem	Specifikimet teknike	Njesia	Sasia
----	------------	-----	----------------------	--------	-------

? Fillimisht ju sqarojme se OEM do te thote: (Original Equipment Manufacturer) , qe perkthehet : “Origjinal I Prodhuesit te Paisjes “,

Ky eshte nje specifikim teknik kufizues dhe drejton OE drejt nje prodhuesi te vetem, qe eshte ai qe ka prodhuar paisjen. Ky specifikim kufizon konkurrencen dhe shkel parimet e trajtimit te barabarte, transparences dhe diskriminimit te cilat I percakton LPP 162/2020. Referuar LPP, , rregullores te prokurimit publik dhe udhezimeve te ndryshme te APP, krahas fjales OEM, AK duhet te shtojte dhe fjalen : ose ekuivalent”

Ju sjellim ne vemendje shtojcen 5 specifikimet teknike ne DST, ne te cilen percaktohet:

“SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose ekuivalent”. “ Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se:

“Ekuivalente është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.”

Njoftimi Nr.8297/3, date 23.01.2020 I APP, percakton se:

Gjithashtu, ne procedurat e prokurimit me objekt Blerje tonera , ne te cilat autoritetet kontraktore kerkojne qe tonerat te jene origjinale, duhet te perfshijne edhe fialelet ose ekuivalent . Kerkesa per tonera origjinale pa perfshire termin ose ekuivalent , con vetem tek prodhuesit e pajisjeve. per te

cilat kerkohen tonerat, duke shmangur prodhues te tjere qe ofrojne tonera ekuivalente me originalet. Kjo me pas sjell si pasoje kufizim te piesemarrjes dhe konkurrences ne keto procedura prokurimi.

Ne keto kushte, kerkojme modifikimin e specifikimeve, duke perfshire edhe termin “ ose ekuivalent”

? Me tej, po ne specifikimet teknike, per disa zera AK ka vendosur vetem nje kod boje dhe nuk ka pershire kodet ekuivalente per bojrat, si psh:

Nr	Pershkrimi	Oem	Specifikimet teknike	Njesia	Sasia
7	Boje Printeri 1018 Hp	lasejet Q2612A	Q2612A	E pahapur,	me Qr Code qe tregon origjinalitetine produktit sipas kompanise prodhuese te paisjeve cope 30

Ju kujtojme se per nje pajisje, mund te funksionojne bojra me kode te ndryshme. Psh per artikullin Nr. 7 , per modelin e printerit te percaktuar , ka dhe boje me kod ekuivalent per kete pajisje e cila ka te njejtin kapacitet printimi, konkretisht, njeri nga kodet ekuivalente eshte: Q2612AC.

Sjellim ne vemendje dhe qendrimet qe ka mbajtur KPP ne te tilla raste. Psh, njeri nga keto vendime eshte : Vendimi Nr. Nr.495/2021, ku KPP shprehet:

“KPP pasi shqyrtoi argumentet e operatorëve ekonomikë ankimes, kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, si edhe dokumentacionit dhe informacionit të këtij të fundit drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik si dhe nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi, vëren se kërkesa e autoritetit kontraktor për tonerin xerox me dy kode përkatëse nuk ka asnjë element kufizues për operatorët ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se operatorët ekonomikë duke pasur dy kode në dispozicion kanë mundësi të ofertojnë për njërin prej tyre, ndërsa e rëndësishme për autoritetin kontraktor do të jetë përputhja e mallit të ofertuar me specifikimet teknike. Nëse të dyja kodet e vëna në dispozicion nga ofertuesit dhe të kërkuara nga autoriteti kontraktor do të dëshmojnë se plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara për mallrat objekt prokurimi ato duhet të jenë të pranueshme nga autoriteti kontraktor.”

Sa me sipër kerkojme qe te modifikohet ky kriter, dhe te pranohen dhe bojrat me kode ekuivalente, me karkteristika te barasvlefshme.

? Po ne tabelen ku pasqyrohen specifikimet teknike, verejme se AK ka kerkuar: “E pahapur, me Qr Code qe tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanise prodhuese te paisjeve”

Fillimisht per sa kemi sqaruar dhe me lart, kerkesa per bojra nga kompania prodhuese e pajisjes eshte ne kundeshitim me parimin e ekuivalences. Bazuar ne LPP, udhezime te ndryshme te APP, AK nuk duhet te kerkojne tonera nga prodhuesi i pajisjes, pasi kjo kerkesa kufizon konkurrencen e lire dhe cenon parimet baze te LPP.

Gjithashtu vlen per t’u permendur se kodi qr eshte numer identifikimi i cili vlen per prodhuesit e tonerit. Kodi Qr mund te mos jete pjese e cdo toneri. Ky element varet teresisht nga politikat e prodhuesit, dhe nuk eshte ne dore te OE. Kodi QR nuk tregon cilesine e nje produkti si dhe nuk garanton funksionalitetin e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin 325/2020, arsyeton se AK nuk mund te hartojte te tilla kerkesa “pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e oferteve teknike”:

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përpunueshmërisë së produkteve, kjo

pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e oferteve teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor... Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Sa me sipër kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

? Tek specifikimet teknike për artikullin leter A4 dhe leter A3, AK ka kërkuar që produkti të përmbushë specifikimet teknike si më poshtë:

20	Leter A4/80gr	Leter A4 80gr/m <sup>2</sup> -Permasa 210x297mm, Lemushmeria 80-130 ml/min-Amballazhimi mbeshtellje kundër lageshtires-Lageshtia 3.5-4.5%-Dukshmeria:>94%-Shkelqimi 101-115%-Bardhesia 57-163	risem	1500
21	Leter A3	Leter A3 80gr/m <sup>2</sup> -Permasa 297mm x 420mm, Lemushmeria 80-130 ml/min-Amballazhimi mbeshtellje kundër lageshtires-Lageshtia 3.5-4.5%-Dukshmeria:>94%-Shkelqimi 101-115%-Bardhesia 57-163	risem	50

Ne përmbushje të këtyre specifikimeve AK nuk ka kërkuar asnjë dokument provues. Si do të vertetohet përmbushja e specifikimeve të kërkuara? Specifikimet teknike të letres , vertetohen me dokumenta të leshuara nga prodhuesit ose distributorët e tyre. Në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë , OE të jenë në kushte të barabarta vlerësimi si dhe AK të jetë i mbrojtur për produktin final që do të levrohet, gjykojmë të nevojshme që AK të kërkojë skedën teknike ose çdo lloj dokumenti provues, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të letres. Ky dokument do të garantonte parimet e transparencës dhe vlerësimin të drejtë. Kjo kërkesë, vjen për të parandaluar situatën që na kanë ndodhur, ku AK ka kërkuar pikërisht këto dokumenta shtesë , në fazën e vlerësimit, pas hapjes së ofertave, duke krijuar konfuzion dhe diskriminim të OE.

Po paraqesim këtë ankesë mbështetur në LPP, Udhëzimet e APP, duke kërkuar modifikim të disa kërkesave të tenderit.

##### 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

##### 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

---



---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

nuk ka

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

aarapi@infosoftoffice.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Frederik Prodani